




# Kanceri i mushkërive (kanceri pulmonar)

## Karcinoma bronkiale



### Mushkëria

Gjatë frymëmarrjes, fryma përkthohet në rrugë të gjatë. Fillimisht ajo rrymon nga hapësira e hundës, gojës dhe fytit në skërfyell (laring) dhe më pas në bronket (rrugët e frymëmarrjes në mushkëri)

Dy bronket kryesore të çojnë drejt dy krahëve të mushkërive, të cilët gjenden në anën e djathtë dhe të majtë të koshit të krahërorit. Bronket degëzohen gjithnjë e më shumë, kalojnë te bronkeolet më të imëta dhe përfundojnë më në fund tek alveolet (filluskat e mushkërive). Aty oksigjeni i thithur nga ajri kalon në gjak, ndërsa njëkohësisht, dioksid-karboni, nga gjaku kalon në ajër për t'u nxjerrë më në fund përmes.

Përkundrejt murit të krahërorit mushkëria është e mbështjellë me anë të pleurës (këmishëzës së krahërorit). Bëhet fjalë për një cipë të hollë, e cila në një anë mbështjell mushkërinë, ndërsa në anën tjetër, vesh zgavrën e krahërorit nga brenda. Midis këtyre të dyja pleura-fletëve ndodhet një e çarë (zgavra e pleurës).

Kanceri i mushkërive, ose më saktë: kanceri bronkial – zë fill pothuajse gjithmonë në qelizat mukozale, të cilat veshin bronket nga brenda. Dallohen dy forma kryesore të kancerit të mushkërive:

- > Karcinomat jo-qelizëvogle (nonparvocelulare) të mushkërive (NSCML), rreth 80% e të gjitha karcinomave të mushkërive
- > Karcinomat qelizëvogle (parvocelulare) të mushkërive (SCML), rreth 20% e të gjitha karcinomave të mushkërive

Të dyja format dallohen midis tyre në mes tjerash varësisht nga trajtimi dhe prognoza. Veçanërisht natyrëkeqe është karcinoma parvocelulare e mushkërive: kur të jetë zbuluar, në shumicën e rasteve ajo tashmë ka formuar metastaza.

Disa lloje tumoresh, si psh. kanceri i gjirit, mund të formojnë metastaza (pinjoj) edhe në mushkëri. Për pasojë në vazhdim do të bëhet fjalë vetëm për tumoret e mirëfilltë të mushkërive.

### Incidenca

Në Zvicër për çdo vit sëmuren rreth 3600 veta nga kanceri i mushkërive, gjë që përbën 10% të të gjithë të sëmurëve nga kanceri. Dy të tretat e të prekurve janë meshkuj, një e treta femra. Kanceri i mushkërive, sa i përket incidencës, tek meshkujt zë vendin e dytë, ndërsa tek femrat vendin tretë të llojit të kancereve.

Tek meshkujt numri i të sëmurëve nga kanceri i mushkërive dekadave të fundit ka pësuar një rënie të lehtë. Përkundrazi, shkalla e prekjes së femrave nga kjo sëmundje ka shënuar rritje. Kjo lidhet kryesisht me faktin se është gjithnjë e më i madh numri i vajzave dhe femrave duhanpirëse.

### Simptomat

Në stadin e hershëm kanceri i mushkërive shpesh nuk jep ndonjë simptomë. Për këtë shkak shumë nga tumorët zbulohen vetëm në një stad të vonshëm, atëherë kur janë formuar tashmë metastazat dhe s'mund të shërohen më.

Shqetësimet në vazhdim mund të sinjalizojnë kancerin e mushkërive:

- > Kollitja e ngulmët (rezistente) që mban më shumë se 4 javë.
- > Kollitja kronike («Kollitja e duhanxhiut») që ndryshon papritmas
- > Pështyma (këlbaza) e përgjakshme gjatë kollitjes
- > Frymëzënia
- > Sëmundja e të ftohtit (rrufa) që me gjithë trajtimin mjekësor, nuk shërohet
- > Dhimbja në zonën e krahërorit
- > Humbja e padëshiruar e peshës, lodhja e përherëshme, mungesa e oreksit

### Diagnozat dhe kontrollet

Për diagnostifikimin e kancerit të mushkërive së pari do të bëhet radiografia e koshit të krahërorit. Këlbaza e hedhur jashtë nga kollitja do të ekzaminohet në laborator për prani qelizash kanceroze.

Një kontroll tjetër i rëndësishëm është bronkoskopia (endoskopia e bronkeve): pas një anestezie lokale, mjeku fut në rrugët e frymëmarrjes një aparat të lëvizshëm në formë tubi. Me ndihmën e një kamere ai mund të shqyrtojë me saktësi bronket. Njëkohësisht, mjeku shkëput provat (kampionet) e indeve (biopsia) të cilat do të analizohen më pas nën mikroskop.

Për të konstatuar nëse dhe në ç'masë është përhapur tashmë tumori në organizëm, do të realizohen dhe ekzaminime të tjera, psh. një tomografi kompjuterike e hapësirës së krahërorit, një ultrasonografi e veshkave ose dhe një scintigrafi e kockave.

### Stadet e sëmundjes

Sëmundjet e kancerit ndahen sipas sistemit TNM. Me këtë rast gjykohet zgjerimi i tumorit (T), invadimi i nyjave limfatike (N) dhe eventualisht metastazat e pranishme (M). Kanceri i mushkërive ndahet si vijon:

- T0** S'ka prani tumori
- T1** Tumori është më i vogël se 3 cm; bronket kryesore janë pa tumor
- T2** Tumori është më i madh se 3 cm ose është rritur më shumë se 2 cm në një nga bronket kryesore
- T3** Tumori ka invaduar mukozën, këmishëzën (cipën) e krahërorit ose murin e krahërorit. Mirëpo skërfyelli (laringu) është pa tumor
- T4** Tumori ka depërtuar në organet fqinje, për shembull në laring ose në ezofag
- Tx** Zgjerimi i tumorit nuk mund të gjykohet dot

- N0** Nuk ka invadim nyjash limfatike
- N1** Tumori ka invaduar nyjat limfatike të njërit krah përkatës të mushkërive
- N2** Tumori ka invaduar nyjat limfatike të krahut përkatës të murit të krahërorit ose të laringut
- N3** Tumori ka invaduar nyjat limfatike të krahut tjetër të mushkërive ose nyjat limfatike më të largëta
- Nx** Invadimi i nyjave limfatike nuk mund të gjykohet dot
- M0** Nuk ka metastaza
- M1** Metastaza në organe të tjera (për shembull në veshka, kocka ose tru)
- Mx** Prania e metastazave nuk mund të gjykohet dot

Duke qenë se karcinomat nonparvocelulare dhe ato parvocelulare të mushkërive përhapen me shpejtësi të ndryshme, në mjekësi aplikohen edhe klasifikime të tjera për lloje të veçanta kanceresh.

### Terapia

Se cilat metoda trajtimi do të gjejnë zbatim varet në mes tjerash se cili lloj kanceri është i pranishëm dhe se sa ka përparuar tashmë tumori. Një rol të rëndësishëm luan dhe gjendja e përgjithshme shëndetësore e pacientit ose pacientes, sidomos kapaciteti veprues i mushkërive luan një rol të rëndësishëm.

Po që se tumori zbulohet në një stad të hershëm, sipas mundësisë, ai do të hiqet në formë operative. Më pas, sipas rregullit, zakonisht zbatohet kimioterapia dhe/ose terapia rrezatuese. Te disa nga pacientet ose pacientët kimioterapia zbatohet qysh para ndërhyrjes operative, ajo do ta zvogëlojë kështu tumorin deri në masën sa të shtohen shanset për sukses të operacionit (kimioterapia neoadjuvante)

Në rastin e stadeve të përparuara të tumoreve kryesisht nuk pason ndonjë operacion. Pacienti ose pacientja që nga fillimi do të trajtohen me medikamente dhe/ose me terapi rrezatimi.

### Pasojat e trajtimit

Si pasojë e terapisë, por edhe si pasojë e vetë sëmundjes kanceroze, disa nga pacientët vuajnë nga shqetësime në frymëmarrje. Këto do të trajtohen sipas shkaktarëve që kanë për bazë, për shembull me medikamente, me inhalim të oksigjenit ose përmes ndonjë ndërhyrjeje.

### Paskontrollet

Pas përfundimit të trajtimit të kancerit, pacientët duhet t'i vizitojnë rregullisht mjekët e tyre për kontrolle përkujdesëse të mëpasme. Ata do t'u japin secilit pacient rekomandime individuale se cilat kontrolle në cilin hark kohor janë të domosdoshme.

### Faktorët rrezikues

Faktori rrezikues pakrahasimisht më i lartë për kancerin e mushkërive është duhanpirja. Rreth 90% e të gjitha rasteve të kancerit të mushkërive shkaktohen nga duhanpirja. Ekspertët vlerësojnë se pothuajse çdo i dhjeti duhanpirës gjatë jetës së tij sëmurët nga kanceri i mushkërive.

Duhanpirja nuk i bën dëm vetëm vetë duhanpirësit apo duhanpirëses – edhe joduhanpirëset e joduhanpirësit, të cilët detyrohen të thithin tym duhani (duhanpirja pasive), kanë një shkallë të lartë rrezikimi nga kanceri i mushkërive.

Edhe disa nga substancat kimike shtojnë rrezikun nga kanceri i mushkërive, për shembull azbesti, pluhuri i kuarcit ose gazi fisnik i radonit, i cili shfaqet në formë të natyrshme në mjedis. Si kancer-shkaktues ndikon edhe pluhuri i imët, para së gjithash bloza e dizelit.

### Parandalimi dhe zbulimi i hershëm

Masa më e rëndësishme për parandalimin e kancerit të mushkërive është mospirja duhan. Lënia e duhanit shpaguehet në secilën moshë. Kush nuk pi (më) duhan, jo vetëm ul rrezikun vetjak për kancer të mushkërive, por edhe rrezikun për shumë sëmundje të tjera, për shembull për infarkt të zemrës, angina pectoris, pikën në tru, çregullimet në qarkullimin e gjakut në këmbë, si edhe rrezikun për kancer në zgavrën e gojës, ezofag ose në fshikëzën urinare.

### Shënim

Ky informacion mund të shkarkohet nga [www.krebsliga.ch](http://www.krebsliga.ch) → Krebskrankheiten (Sëmundjet kanceroze) edhe në gjuhët gjermanisht, frëngjisht, italisht, spanjisht, portugalisht, serbisht-kroatisht-boshnjakisht dhe turqisht. Mos harroni dhe broshurat tona falas në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht nën [www.krebsliga.ch/broschueren](http://www.krebsliga.ch/broschueren).

## Informacion, Këshillim, Mbështetje

### Krebsliga Aargau

Tel. 062 834 75 75  
[www.krebsliga-aargau.ch](http://www.krebsliga-aargau.ch)

### Krebsliga beider Basel

Tel. 061 319 99 88  
[www.krebsliga-basel.ch](http://www.krebsliga-basel.ch)

### Bernische Krebsliga Ligue bernoise contre le cancer

Tel. 031 313 24 24  
[www.bernischekrebssliga.ch](http://www.bernischekrebssliga.ch)

### Ligue fribourgeoise contre le cancer

**Krebsliga Freiburg**  
tél. 026 426 02 90  
[www.liguecancer-fr.ch](http://www.liguecancer-fr.ch)

### Ligue genevoise contre le cancer

tél. 022 322 13 33  
[www.lgc.ch](http://www.lgc.ch)

### Krebsliga Glarus

Tel. 055 646 32 47  
[www.krebsliga-glarus.ch](http://www.krebsliga-glarus.ch)

### Krebsliga Graubünden

Tel. 081 252 50 90  
[www.krebsliga-gr.ch](http://www.krebsliga-gr.ch)

### Ligue jurassienne contre le cancer

tél. 032 422 20 30  
[www.liguecancer-ju.ch](http://www.liguecancer-ju.ch)

### Ligue neuchâteloise contre le cancer

tél. 032 721 23 25  
[www.liguecancer-ne.ch](http://www.liguecancer-ne.ch)

### Krebsliga Schaffhausen

Tel. 052 741 45 45  
[www.krebsliga-sh.ch](http://www.krebsliga-sh.ch)

### Krebsliga Solothurn

Tel. 032 628 68 10  
[www.krebsliga-so.ch](http://www.krebsliga-so.ch)

### Krebsliga St. Gallen- Appenzell

Tel. 071 242 70 00  
[www.krebsliga-sg.ch](http://www.krebsliga-sg.ch)

### Thurgauische Krebsliga

Tel. 071 626 70 00  
[www.tgkl.ch](http://www.tgkl.ch)

### Lega ticinese contro il cancro

tel. 091 820 64 20  
[www.legacancro-ti.ch](http://www.legacancro-ti.ch)

### Ligue valaisanne contre le cancer

tél. 027 322 99 74  
[www.lvcc.ch](http://www.lvcc.ch)

### Krebsliga Wallis

Tel. 027 922 93 21  
[www.krebsliga-wallis.ch](http://www.krebsliga-wallis.ch)

### Ligue vaudoise contre le cancer

tél. 021 641 15 15  
[www.lvc.ch](http://www.lvc.ch)

### Krebsliga Zentralschweiz

Tel. 041 210 25 50  
[www.krebsliga.info](http://www.krebsliga.info)

### Krebsliga Zug

Tel. 041 720 20 45  
[www.krebsliga-zug.ch](http://www.krebsliga-zug.ch)

### Krebsliga Zürich

Tel. 044 388 55 00  
[www.krebsliga-zh.ch](http://www.krebsliga-zh.ch)

### Krebshilfe Liechtenstein

Tel. 00423 233 18 45  
[www.krebshilfe.li](http://www.krebshilfe.li)

### Krebstelefon / Ligne Info- Cancer / Linea cancro

0800 11 88 11  
Nga e hëna në të premten,  
ora 10–18. Gjermanisht,  
frëngjisht, italisht; falas

### migesplus

Schweizerisches Rotes Kreuz  
3084 Wabern  
Tel. 031 960 75 71  
[www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)  
Informacione për migrante  
dhe migrantë

## Impressum

### Autore

Dr. med. Eva Ebnöter,  
Zollikon

### Përkthimi

Bislim Elshani, migesplus

### Ilustrimet

Daniel Haldemann, Wil SG

### Botues

Krebsliga Schweiz  
Effingerstrasse 40  
Postfach 8219  
3000 Bern  
Telefon 031 389 91 00  
[www.krebsliga.ch](http://www.krebsliga.ch)

© 2010

Krebsliga Schweiz, Bern



Broshura u përpilua në kuadër të programit nacional të Entit federal për shëndetësi Migracioni dhe shëndetësia 2008–2013. [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch) – Informacione shëndetësore në shumë gjuhë.